



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 7 akti

Nr. 13 Vendimi

Tiranë, më 5.4.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i përbërë nga trupa gjyqese:

Alma Faskaj (Vokopola)	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relator
Xhensila Pine	Anëtar

me sekretare gjyqësore Znj. Ina Serjanaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z.Theo Jacobs, në Tiranë, më datat 04 prill 2018, ora 10:00 dhe 05 prill 2018, ora 9:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Vitore Tusha, gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit**

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 14, 55 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Valbona Sanxhaktari, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, avokatin Z. Arben Vani, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike rivlerësimin kalimtar ndaj subjektit Vitore Tusha, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, me dekret të Presidentit të Republikës nr. 56514, datë 11.02.2008, është emëruar gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese. Dekreti i Presidentit për emërimin e Znj. Vitore Tusha ka marrë pëlqimin e Kuvendit më datë 18.02.2008. Subjekti i rivlerësimit, Znj. Tusha, që nga data 18.02.2008 e deri aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën e gjyqtares në Gjykatën Kushtetuese.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 06.11.2017, bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, ka hedhur shortin, në bazë të të cilit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupa gjyquese me përbërjen e lartpërmendur. Relator i çështjes, u zgjodh me short komisionere Valbona Sanxhaktari.

Me vendimin e datës 06.11.2017, trupa gjyquese, në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, ka zgjedhur si kryesuese për këtë çështje anëtarin Alma Faskaj. Trupa gjyquese vendosi për fillimin e hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar Z. Theo Jacobs.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- 1) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- 2) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- 3) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- 4) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- 5) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

¹ Me shkresën me nr. *** prot., datë 06.11.2017, e përbërë nga 21 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

DSIK ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha.”*

KLD ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes në tërësi, është konkluduar se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Pasi hetova raportin e përgatitur nga Inspektorati i KLD-së dhe denoncimet nga publiku, nuk gjeta indice apo elemente që mund të ngrija dyshime për paafësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, duke propozuar vlerësimin “E aftë”.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.”

Trupa gjyquese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 09.03.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit u lajmërua se ka të drejtë të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së disa prapësimeve.

Gjatë të gjitha fazave të hetimit administrativ është komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupa gjyquese vlerëson se subjekti ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2017, dërgohet raporti i Inspektoratit të KLD-së.

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, aktualisht është gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësisë profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë; Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, shoqëria “****” sh.p.k., Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Parandalimit të Parave, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Inspektorati i KLD-së.

I. Vlerësimi i pasurisë

I.1 Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit organik nr. 84/ 2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjekte të së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

1. Pasuria: Apartament, ndodhur në rrugën “****”, me sipërfaqe 74 m², ndërtuar në vitin 1991, i përfituar nga ligji për privatizimin e banesave, nëpërmjet kontratës së shitblerjes me Ndërmarrjen Komunale Banesa ***⁴. Këtë apartament, bashkëpronarët (subjekti i rivlerësimit me bashkëshortin, Z. P. T.) ia shesin/dorëzojnë Entit Kombëtar të Banesave⁵.

Enti Kombëtar i Banesave ia shet subjektit të rivlerësimit, vajzës R. T. dhe bashkëshortit, Z. P. T. (secili zotëron 33%), apartament banimi (3+1) me sipërfaqe totale 136.76 m² (sip. shfrytëzimi 118.92 m²) rruga “****”, Tiranë.

Vlera e apartamentit, pas rivlerësimit në vitin 2012, është 16.411.200 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.

Aktualisht apartamenti është në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, bashkëshortit P. T. dhe vajzës R. T.

⁴ Shih në dosje kontratën e shitblerjes, datë 19.08.1993, ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa 1 dhe Znj. Vitore Tusha dhe Z. P. T.

⁵ Shih në dosje kontratën e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.11.2000, ndërmjet Znj. Vitore Tusha, Z. P. T. dhe Entit Kombëtar të Banesave – Drejtoria Rajonale Tiranë.

Mënyra e fitimit:

Pasuria është përfituar me *kontratë shitjeje me këste* me Entin Kombëtar të Banesave, me çmimin 3.651.608 (tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetë) lekë. Kontrata e shitblerjes (përfundimtare) me Entin Kombëtar të Banesave Tiranë është bërë më datë 20.09.2006. **Hetimi i kryer nga Komisioni**⁶

Pagesa për pasurinë e mësipërme është kryer sipas çmimit me këste, përcaktuar në kushtet e kontratës, dhe është likuiduar tërësisht në datën 04.09.2006. Praktika e ndjekur nga Enti Kombëtar i Banesave është verifikuar dhe është korrekte. Trupa gjyquese vlerëson se, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar këtë çmim.

Në Pyetësor⁷, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera në total e arredimit të apartamentit në rrugën “****”, pall. ***, shk. ***, ap. *** Tiranë, është në shumën 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë dhe se nuk ka kryer asnjë rinovim dhe nuk ka asnjë orendi, dekorim dhe pajisje në shtëpi që tejkalon shumën prej 2.500 (dy mijë e pesëqind) eurosh.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer.

2. Pasuria: Tokë arë 500 m², ndodhur në ***, Tiranë, 100% pjesë e subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha⁸.

Mënyra e fitimit:

Kjo pronë është blerë⁹ nga subjekti i rivlerësimit gjatë kohës që ajo ka qenë avokate (në vitin 2007) me një çmim 400.000 (katërqind mijë) lekë¹⁰.

Hetimi i kryer nga Komisioni¹¹

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore.

3. Pasuria: Apartament me sipërfaqe 35.47 m², në bashkëpronësi me bashkëshortin, ndodhur në zonën kadastrale ***, nr. pasurie ***, Durrës, me vlerë 59.000 (pesëdhjetë e nëntë mijë) euro¹². Apartamenti është i tipit “dupleks” me sipërfaqe totale banimi 118 m². Zotërimi 50 % me bashkëshortin.

Truall nën apartamentin e mësipërm në funksion të tij, sipërfaqe 178.9 m², në bashkëpronësi me bashkëshortin, ndodhur në Durrës, Lalëz, me vlerë 331,657 (treqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë¹³. Zotërimi 50 % me bashkëshortin¹⁴.

⁶ Shih në dosje shkresën drejtuar Entit Kombëtar të Banesave nr. *** prot., datë 11.01.2018, si dhe kthimpërgjigjen e Entit Kombëtar të Banesave nr. *** prot., datë 25.01.2018.

⁷ Pyetësori i parë dërguar subjektit të rivlerësimit, datë 26.12.2017.

⁸ Fituar me kontratë shitblerjeje nr. *** rep. *** kol., më 18.10.2007.

⁹ Të ardhurat nga aktiviteti privat “Avokat” për vitin 2005-2007.

¹⁰ Shkresën nr. 1824 prot., datë 13.02.2018, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, informacion mbi çmimin e referencës, si dhe mbi çmimet me të cilat janë blerë këto toka nga kufitarët.

¹¹ Shih në dosje shkresat dërguar ZVRPP-së Tiranë për këtë pronë.

¹² Shih në dosje kontratën e sipërmarrjes, datë 08.10.2010, e lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., pa praninë e noterit dhe kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.09.2013.

¹³ Shih në dosje kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.09.2013 me ALUIZNI-n (tokë shtetërore).

¹⁴ Burimet e krijimit të të ardhurave për apartamentin dhe truallin: të ardhurat nga veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, si nga paga në Gjykatën Kushtetuese, pedagoge në Shkollën e Lartë jopublike “Justicia”, pedagoge në Akademinë Profesionale të Biznesit Tiranë, pedagoge në Shkollën e lartë jopublike “Illyria” etj; nga veprimtaria e bashkëshortit, si pensioni i parakohshëm, pagat etj., nga veprimtaria e së bijës E. T., si paga në Avokaturën e Shtetit, nga aktiviteti noteri.

Hetimi i kryer nga Komisioni¹⁵

Në kartelat e pasurisë të administruara kryesisht, figuron se data e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit në Hipotekë (me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.09.2013), është 17.06.2013, dhe data e kontratës është 10.09.2013. Pas verifikimit të këtij fakti u konstatua se aplikimi (sipas formularit të Hipotekës, bashkëlidhur) ishte në datën 17.09.2013 dhe data e shënuar në kartelë ishte një lapsus.

Kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, sipas së cilës Drejtoria e ALUIZNI-t “Tirana 3” i shet subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj truallin, ku në pronësi të blerësit kalon sipërfaqja takuese e truallit prej 178.9 m², është lidhur në datën 09.09.2013.

Kontrata e shitjes së apartamentit, e cila i kalon titullin e pronësisë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, është në datën 10.09.2013.

U verifikua kjo procedurë tek ALUIZNI16 dhe u konsiderua korrekte, pasi kontrata për shitblerjen e truallit është mbështetur në kontratën e sipërmarrjes.

Pagesat për blerjen e apartamentit “dupleks”, në zotërim të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj, në Gjirin e Lalëzit, për vlerën 59.000 (pesëdhjetë e nëntë mijë) euro, nuk janë shlyer me transaksione bankare, por me fatura të lëshuara nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe vetëm për vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro. Pjesa tjetër e shumës ka kaluar nga *llogaria klient në llogarinë hua*.

Në bazë të pyetjeve të bëra subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, u sqarua se pagesat janë kryer në arkën e shoqërisë sipas marrëveshjes verbale midis palëve edhe për të minimizuar shpenzimet e tjera financiare, pasi detyrimi për çmimin e apartamentit është në euro, ndërkohë që të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur kanë qenë dhe janë në lekë. Pagesat janë kryer *cash* në arkën e shoqërisë nga kursimet që familjarisht ka bërë subjekti dhe personat e lidhur, pas tërheqjes së të ardhurave të tyre familjare nga llogaritë bankare të listuara tashmë¹⁷. Në rastin e pagesës së shumës prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) eurosh, të kryer më datë 18.07.2012, ajo kryesisht është mbuluar nga tërheqja e kryer nga bashkëshorti, disa ditë më parë, në llogarinë e tij në bankën “Credins”¹⁸ dhe është plotësuar nga kursimet familjare si më sipër¹⁹.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka mobiluar këtë apartament për një vlerë 1.050.000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë.

Si konkluzion, rezulton se pagesat për këtë apartament nuk janë kryer në rrugë bankare, apo në ndonjë formë që mund të verifikohet pagesa e tyre korrektësisht. Megjithatë, rezultoi se në tërësi të ardhurat e subjektit janë të mjaftueshme për të përballuar këto pagesa.

¹⁵Shih në dosje shkresën nr. *** prot., datë 09.02.2018, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, si dhe kthimpërgjigjen e ZVRPP-së Durrës, nr. ***, datë 22.02.2018.

¹⁶ Siç vihet re, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore me ALUIZNI-n është bërë përpara kontratës së shitjes së objektit. Sipas nenit 2, germa “dh”, të ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, subjekti i interesuar, personi fizik apo juridik, i cili gëzon njësinë e ndërtuar dhe që ka kryer një veprim juridik të drejtpërdrejtë apo të rrjedhur me personin e stimuluar për kalimin e të drejtave reale mbi njësinë e ndërtuar, të ngritur brenda zonës së simuluar, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, gëzon të drejtën për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore. Neni 4/b, subjekti paraqet – kërkesën dhe dokumentacionin që provon veprimin juridik ndërmjet personit të stimuluar dhe subjektit të interesuar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar.

¹⁷ Për më tepër shih në dosje “Pyetësorin nr.5”.

¹⁸ Të ardhura prej 1.613.955 lekësh, që i janë depozituar në zbatim të titullit ekzekutiv të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 11633, datë 11.07.2011, për rillogaritjen e pensionit.

¹⁹ Për më tepër shih në dosje “Pyetësorin nr. 6”, datë 22.02.2018.

4. Detyrime

Marrëdhënie huaje me shoqërinë “****” sh.p.k., e krijuar nga transferimi i kontratës së sipërmarrjes së datës 08.10.2010 në kontratë shitblerjeje për diferencën e çmimit të papaguar në momentin e lidhjes së kontratës (24.000 euro)²⁰ për apartamentin e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, datë 20.09.2013.

Hetimi i kryer nga Komisioni²¹

Detyrimi duhej të shlyhej brenda datës 07.09.2016. Ka rezultuar se ka mbetur pa shlyer si detyrim vlera 17.500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro. Pagesat nuk janë shlyer me transaksione bankare, por me fatura të lëshuara nga shoqëria (pra është paguar *cash*).

*Për sa më sipër, është hetuar marrëdhënia ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit.*

Shoqëria “****” ka shpjeguar se mospërmbushja e detyrimit brenda afatit trevjeçar ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të gjendjes financiare të huamarrëses. Shlyerja e pjesës tjetër do të bëhet sipas afatit të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes. Ndërkohë që rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e shitblerjes dhe ka regjistruar objektin në emër të saj, pa barrë hipotekore, në llogari të shoqërisë “****”, ndaj së cilës rezulton ende me borxh.

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, shprehet²² se marrëdhënia ndërmjet saj dhe shoqërisë “****” është, përveçse kontraktore, edhe mirëbesimi, për shkak të marrëdhënieve miqësore, rreth 25-vjeçare, me familjen e ortakut të shoqërisë.

Penalitetet për mospërmbushjen e detyrimit, të parashikuar në kontratën e huas, nuk janë aplikuar deri më sot, pasi palët kanë rënë dakord me marrëveshje verbale që afatin e përmbushjes së detyrimit ta zgjasin deri në vitin 2020, duke iu referuar parashikimit fillestar të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së datës 08.10.2010. Kjo është arsyeja që marrëveshja verbale në lidhje me zgjatjen e afatit nuk u formalizua me shkrim, në mënyrë që kontrata ekzistuese e huas të ketë vlerë juridike jo vetëm për detyrimin e mbetur, por edhe për penalitetet (duke filluar që nga shtatori i vitit 2013), nëse nuk do të respektohet afati i zgjatur.

*Gjithashtu, në Pyetësor subjekti i rivlerësimit është pyetur mbi arsyet e mosshlyerjes së detyrimit ndaj shoqërisë “****” dhe kalimin nga llogaria klient në llogarinë hua, si dhe arsyet e ndryshimeve të gjendjes financiare të huamarrëses (shpjegim ky i dhënë nga shoqëria “****”).*

Lidhur me këtë pyetje, Znj. Tusha ka deklaruar se në prill të vitit 2013, shoqëria “****” është pajisur me certifikatë pronësie për apartamentin e kontraktuar prej saj. Ky fakt shërbeu si pikënisje e negociatave mbi kalimin e pronësisë në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj. Për këtë qëllim u bisedua në lidhje me shumën e pashlyer nga Znj. Vitore Tusha dhe Z. P. T. Duke menduar se me kalimin e pronësisë te porositësit, shoqëria evitonte pagesën e taksave që rëndonin mbi pronën, si dhe për të pakësuar shpenzimet e tjera financiare që lidhen me vendosjen/heqjen e barrave hipotekore, u ra dakord që shuma e mbetur të shlyhej në formën e huas, sipas kushteve të kontratës së nënshkruar në shtator të vitit 2013.

²⁰ Shih në dosje kontratën e huas, datë 07.09.2013, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., dhe subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, lidhur në zyrën e shoqërisë “****”.

²¹ Për më tepër shih në dosje shkresën me nr. 321 prot., datë 11.01.2018, të shoqërisë “****”, si dhe kthimpërgjigjen e shoqërisë “****”, nr. ***prot., datë 16.01.2018.

²² Shih në dosje “Pyetësorin nr. 4”

Nuk është arritur përmbushja e detyrimit të huas në afatin e caktuar, për shkak të pakësimit të të ardhurave financiare familjare. Nga shkurti i vitit 2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është larguar nga detyra, si punonjës aktiv i Policisë së Shtetit, çfarë ka passjellë një përgjysmim të të ardhurave të tij mujore. Gjithashtu, në shtator të vitit 2015, djali i subjektit të rivlerësimit filloi shkollën e mesme, duke kaluar nga arsimi publik në atë privat.

Në përfundim të hetimit konstatohet nga trupa gjyquese se situata është e njëjtë me atë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

5. Gjendja në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emër të Znj. Vitore Tusha, në datën 31.12.2016, është: 50.901 (pesëdhjetë mijë e nëntëqind e një) lekë. Zotërimi 100 %.

6. Kartë krediti në “Raiffeisen Bank”, në emër të Znj. Vitore Tusha, 1.000 (një mijë) euro. Zotërimi 100 %.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimet e kryera nuk ka dyshime mbi këto llogari. Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me verifikimin e kryer.

7. Pasuria: Automjet “Volkswagen Gol 1.9” SD, kambio manuale²³, me vlerë 9.500 euro²⁴ me targë ***, në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Z. P. T., 100%.

Nuk ka dyshime mbi këtë aset (makinë). Përputhet deklarimi i subjektit me verifikimin e kryer.

8. Pasuria: Gjendje në cash, datë 31.12.2016, vlera: 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë. Në zotërim 100% nga vajza e subjektit të rivlerësimit, Znj. E. T.

Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

9. Pasuria: Gjendje në llogari rrjedhëse në Bankën Kombëtare Tregtare, më datë 31.12.2016, vlera: 5.494 (pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë. Në zotërim 100% nga vajza e subjektit të rivlerësimit, Znj. E. T.

Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

10. Pasuria: Gjendja në llogarinë rrjedhëse në “Unicredit”, më datë 31.12.2016, 582 (pesëqind e tetëdhjetë e dy) euro, në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit, Znj. R. T.

Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

11. Të dhënat për xhirot nga ushtrimi i aktivitetit privat si avokat, në vitet 2005-2008

Për saktësimin e këtyre të dhënave u është kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore²⁵.

Të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit u konfirmuan nga Drejtoria Rajonale Tatimore (2005-2006) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, (2007-08).

12. Gjatë hetimit, nga të dhënat që erdhën nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Z. P. T., figuron të ketë qenë ortak dhe administrator në shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt të veprimtarisë së saj ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private në pronësi ose përdorim të personave fizikë ose juridikë, shqiptarë ose të huaj, në të

²³ Shih në dosjen e ILDKPKI-së kontratën e shitjes, datë 11.01.20017, ndërmjet Z. P. T. dhe firmës “****” sh.p.k.

²⁴ Të ardhurat nga pagat personale për periudhën 2003-2007.

²⁵ Shih në dosje shkresat nr. ***prot., datë 11.12.2017; nr. *** prot., datë 10.01.2018; nr. ***prot., datë 23.01.2018.

gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, regjistruar me vendimin nr. 26619, datë 05.11.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kapital 4.000.000 lekë. Më tej, Z. P. T. është larguar si ortak dhe administrator, pasi në vitin 2005 shiti 100% të kuotave²⁶.

Nga verifikimi që u bë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, rezultoi se shoqëria “****” sh.p.k., në Gjykatë është regjistruar më datë 05.11.2001 dhe në Tatime më datë 10.02.2005.

Nga subjekti i rivlerësimit dhe nga personat e lidhur me të nuk përmendet ky aset dhe as burimi i krijimit të kapitalit të shoqërisë. Po ashtu, nuk deklarohet shitja e saj dhe asnjë e ardhur nga kjo shoqëri për periudhën 2001- 2005.

Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, Znj.Vitore Tusha, shprehet se arsyeja për të cilën nuk janë pasqyruar në Formularin e Vetting-ut këto të dhëna në lidhje me shoqërinë “****” *ka të bëjë thjesht me faktin se nga të gjitha veprimet e kryera që nga themelimi i shoqërisë e deri në transferimin e kuotave, nuk ka pasur asnjë element pasuror të lidhur me subjektin e rivlerësimit apo bashkëshortin e saj*²⁷.

Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit duken bindëse dhe të mjaftueshme.

13. Në vitin 2008, kur subjekti ka kryer deklarinimin për herë të parë, fëmijët e subjektit të rivlerësimit kanë qenë të moshave, si më poshtë:

1. R. P. T. 24 vjeç;
2. E. P. T. 20 vjeç;
3. A. P. T. 8 vjeç.

Për sa më sipër, i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, e cila ka deklaruar shpenzimet për arsimin e fëmijëve²⁸, si më poshtë vijon:

1. E. T. është diplomuar në Drejtësi pranë Universitetit “Luarasi”, Tiranë.

Në vitin kalendarik 2008 është paguar shuma 4000 euro;

Në vitin kalendarik 2009 është paguar shuma 4000 euro;

Në vitin kalendarik 2010 është paguar shuma 2000 euro.

Gjithashtu, Znj. E. T. ka kryer një kurs trajnimi në periudhën 14.01.2011-23.03.2011 në Universitetin e Studimeve në Milano, paguar 516 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë euro) dhe me qëndrim të afërmit në ***, e cila është adresë e motrës së subjektit të rivlerësimit.

2. A. T. ka frekuentuar shkollën e mesme “Faik Konica” me tarifa si më poshtë:

Shtator 2015-dhjetor 2015 është paguar shuma 1000 euro;

Janar 2016 – dhjetor 2016 është paguar shuma 1600 euro;

Janar 2017-dhjetor 2017 është paguar shuma 1500 euro.

3. Gjatë periudhës së shkollimit (2002-2006) dhe qëndrimit (2006-2010), *vajza R. T. është mbështetur financiarisht për shpenzimet e jetesës nga të dyja motrat e subjektit.* Për kohën e qëndrimit në Kolegjin Fetar për dy vite (2002-2004), motrat e subjektit të rivlerësimit kanë paguar afërsisht shumën 2000 euro për secilin vit. Ndërsa për periudhën më pas, ato kanë mbuluar

²⁶ Shih në dosje shkresën nr. *** prot., datë më 25.01.2018 të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

²⁷ Shih në dosje në “Pyetësorin nr. 4”.

²⁸ Për më tepër shih pyetësorët në dosje.

shpenzimet më të rëndësishme jetësore brenda kostos së shpenzimeve të tyre familjare. Po ashtu, nga viti 2004 deri në vitin 2010, vajza ka punuar me kontrata punësimi të pjesshme, por edhe pa kontrata punësimi. Me mbështetjen e motrave të subjektit të rivlerësimit, Znj. R. T. ka përballuar jetesën në këtë periudhë (2002 -2010).

I. 2 Rekomandimi për vlerësimin e pasurisë

Sa më sipër, pavarësisht nga raporti i hollësishëm i dërguar nga ILDKPKI-ja, për të bërë një vlerësim të pasurisë së subjektit të rivlerësimit sa më objektiv dhe të paanshëm është kryer hetim administrativ i pavarur nga ana e Komisionit.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi edhe personat e lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore. Të dhënat për xhirot nga ushtrimi i aktivitetit privat “Avokat”, në vitet 2005 - 2008, mbahen në konsideratë sipas deklarimit të bërë. Edhe të dhënat dhe shpjegimet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me qenien si ortak dhe administrator në shoqërinë “****” sh.p.k., janë vlerësuar bindëse dhe të mjaftueshme gjatë hetimit administrativ.

Lidhur me shpenzimet e deklaruara për arsimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se shpenzimet e jetesës janë mbështetur financiarisht nga motrat e subjektit dhe pjesërisht nga punësimi me kontrata të pjesshme dhe, sipas rastit, edhe pa kontrata punësimi. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se të ardhurat e motrave të saj kanë qenë të mira dhe të mjaftueshme për të përballuar këto shpenzime. Po ashtu, vlerësohet fakti se gjatë periudhës së shkollimit (2002-2006), subjekti i rivlerësimit ka ushtruar profesionin e avokatit.

Nën dritën e gjetjeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

II. Vlerësimi i aftësive profesionale

II.1 Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;

Për subjektin e rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, nuk ka të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ajo ka ushtruar në këtë periudhë.

Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së, mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe mbi 5 dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, konstatohet:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka njohuri të gjera ligjore, të cilat përfshijnë njohuri të së drejtës kushtetuese, të së drejtës ndërkombëtare gjer te ligjet e brendshme. Vihet re thellimi i analizës së çështjes, duke marrë informacion jo vetëm për legjislacionin e brendshëm mbi çështjen që është në diskutim, por duke kërkuar nga Drejtoria e Studimeve Juridike paraqitjen e studimeve të veçanta. Në tri dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën kushtetuese të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti njez mirë çështjet procedurale në funksion të zgjidhjes së saktë të themelit të çështjes.

Ajo përdor metodën e interpretimit krahasimor me legjislacionin ndërkombëtar apo të shteteve të tjera. Kur është rasti, përdor edhe referenca në praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

b) Arsyetimi ligjor

Në analizë të përbashkët të dokumenteve dhe dosjeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi të dukshme në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të plota, të qarta dhe të kuptueshme. Në arsyetimin e vendimeve, ajo mban në referencë pretendimet e palëve, duke i përballur ato me konceptet kushtetuese për të nxjerrë më pas konkluzionet. Në këtë mënyrë, përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së vendimit të arsyetimit gjyqësor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese. Subjekti ka deklaruar se në tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar gjithsej 114 çështje dhe ka përfunduar 112 prej tyre, duke mbartur në vitin e fundit të detyrës vetëm 39 çështje. Këto të dhëna statistikore nuk shoqërohen me vërtetim nga institucioni dhe nuk janë të ndara me vite. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 98.2%.

Sipas të dhënave të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 106 çështje. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 23 ditë deri në 11 muaj e 29 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, prej 11 muajsh e 29 ditësh, ka qenë çështje themeli dhe në përfundim është disponuar me vendim pranimin pjesërisht të kërkesës. Shkak për vonesën është bërë edhe leja vjetore e gjyqtarëve, por edhe kohëzgjatja për marrjen e vendimit dhe më pas arsyetimin e tij.

Gjithashtu, konstatohet se shqyrtimi i çështjeve në tri raste ka filluar jashtë afatit 2-mujor nga paraqitja e kërkesës. Në dy raste të tjera, ky afat është respektuar.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, ku seancat kanë qenë produktive, duke ndjekur rendin: 1 (një) seancë në Kolegj (në të 5 dosjet), 1 (një) seancë në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe të paktën 2 (dy) seanca plenare. Njoftimet janë kryer sipas afateve ligjore në çdo rast dhe nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve. Gjithashtu, ajo ka marrë masat për përgatitjen e materialeve paraprake, si opinione, relacione dhe studime.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në të gjitha rastet ka inventarizim të akteve, ndërsa rezulton se edhe aktet e njoftimit janë të plota për secilën dosje.

Në të 5 dosjet e vëzhguara mungon akti me të cilën gjyqtarja ka vënë çështjen në lëvizje. Relacionet e këshilltares nuk janë të nënshkruara. Në një rast, vetë relacioni i gjyqtares është pa datë dhe pa nënshkrim, ndërsa procesverbali i seancave nuk tregon orën dhe detajet e provave që administrohen. Në dy raste, në dosje gjenden fletë të bardha të administruara mes akteve dhe të numërtuara.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën Kushtetuese, e emëruar nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e subjektit në funksion.

a) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me ndonjë ndikim apo joshje nga presioni i jashtëm.

b) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të saj nga gjykimi i çështjeve. Në tri raste është konstatuar largimi i gjyqtarëve nga gjykimi me dorëheqje, ku në një rast mungon akti i pranimit të dorëheqjes.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese, apo elementeve të tjera, që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk është konstatuar që subjekti të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësia e komunikimit

Në 3 dosjet e vëzhguara në procesverbalin gjyqësor, në format letër, është konstatuar se mënyra e komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse ka qenë e sjellshme, e qetë dhe me respekt ndaj dinjitetit të palëve. Në një dosje nuk evidentohen të dhëna të tilla, pasi është vendosur në Mbledhjen e Gjyqtarëve për moskalim të çështjes në seancë plenare, ndërsa në një rast tjetër shqyrtimi është bërë në seancë plenare mbi bazë dokumentesh pa pjesëmarrjen e palëve. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhënat specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti ka deklaruar se gjatë punës si gjyqtare ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve pa dallim, e specializuar në Të Drejtën Kushtetuese: të drejtat e njeriut - aspekti procedural, kontrolli abstrakt i normës juridike dhe interpretimi i Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit është pajisur me diplomën doktorale në fushën juridike. Znj. Vitore Tusha ka deklaruar se, për shkak të ushtrimit të profesionit, nuk përfshihet në programet e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, ndërsa informon se vetë është lektore e jashtme me kohë të pjesshme te shkolla e lartë jopublike "Luarasi" dhe tek Akademia Profesionale e Biznesit. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës deklaroi se ka marrë pjesë në disa aktivitete. Gjithashtu, ajo është autore e një sërë artikujsh.

II.2 Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, bazuar në denoncimet, si më poshtë:

1. Denoncimi i shtetasit R. T., që ka bashkëlidhur dhe vendimin gjyqësor;
2. Kërkesa ankimore e shtetasit S.R., që ka bashkëlidhur edhe vendimet gjyqësore;
3. Denoncimi i shtetasit R.M., që ka bashkëlidhur dhe vendimin gjyqësor;
4. Denoncimi i shtetasit V. Ç., që ka paraqitur një ankesë;
5. Denoncimi i shtetasit L.K.

Denoncimi 1.

Qytetari R.T., në denoncimin²⁹ e bërë për vendimin gjyqësor 238, datë 14.02.1996, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, denoncon subjektin e rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, për shkelje të etikës profesionale. Denoncuesi ankohet se vendimi është i kundërligjshëm dhe i njëanshëm, duke favorizuar palën e paditur, pasi vajza e palës së paditur punonte në Gjykatën e Kasacionit, pra kolege me gjyqtaren Vitore Tusha. Ky vendim, sipas denoncuesit, nuk është i qartë, pasi nuk rregullon pretendimet e asnjë prej palëve, kur ndërkohë ka fituar në të dyja shkallët e tjera të gjykimit. Sipas denoncimit, Znj. Vitore Tusha ka dhënë vendimin me bazë njohjeje, për të favorizuar kolegen e saj.

Vendimi nr. 238, datë 14.02.1996, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, i cili ka si relatore subjektin e rivlerësimit, i përket periudhës kur Znj. Vitore Tusha ka qenë anëtare e Gjykatës së Kasacionit. Seanca gjyqësore është zhvilluar më datë 14.02.1996. Në përfundim të procesit, Gjykata ka prishur vendimin nr. 3988, datë 23.06.1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe vendimin nr. 1202, datë 04.10.1995, të Gjykatës së Apelit.

Vendimi është i arsyetuar. Në vendimin e Gjykatës së Kasacionit nuk është referuar saktë numri i vendimit të Gjykatës së Apelit.

²⁹ Nr. 1026 prot., datë 13.12.2017.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi R.T., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.

Denoncimi 2.

Me kërkesë ankimore, shtetasi S.R.³⁰ ankohet lidhur me subjektin e rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, pasi sipas denoncuesit ka gjykuar tri herë për të njëjtën çështje:

- a. Me vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 489, datë 26.03.1998;
- b. Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 10.03.2016, ku Znj. Vitore Tusha ishte relatore;
- c. Me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 265, datë 07.10.2017.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi S.R., rezultoi se është e vërtetë që Znj. Vitore Tusha ka qenë anëtare në tri trupat gjyquese, që kanë dhënë vendimet, por objektet e gjykimit kanë qenë të ndryshme. Nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.

Denoncimi 3.

Në denoncimin e shtetasit R.M.³¹ denoncohet subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, për shkelje profesionale dhe gjykim të padrejtë kundër djalit të tij, H. M., i cili është dënuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”. Shtetasi H. M. është dënuar me 7 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me 5 vjet burgim nga Gjykata e Apelit Tiranë. Gjykata e Lartë, pas shqyrtimit të rekurseve të paraqitura nga kërkuesi, që ka kërkuar kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit dhe nga prokurori që ka kërkuar prishjen e vendimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 00-2016-666, datë 21.04.2016, ka vendosur mospranimin e tyre në dhomën e këshillimit.

Me vendimin nr. 1, datë 18.01.2017, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, ku subjekti i rivlerësimit është anëtare, me kërkues shtetasin H. M., me objekt “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 610, datë 01.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të vendimit nr.730, datë 08.04.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; të vendimit nr. 00-2016-666, datë 21.04.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”, vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancën plenare.

Vendimi është i arsyetuar lidhur me shkaqet e moskalimit të çështjes për shqyrtim në seancën plenare. Në vendim janë përdorur si referencë edhe vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga denoncuesi, nuk ka indice për të provuar pretendimin e tij.

Denoncimi 4.

Në denoncimin e shtetasit V.Ç.³², subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, denoncohet për korrupsion, për periudhën kur ka qenë avokate. Sipas denoncuesit, ai ka pajisur me prokurë përfaqësimi Znj. Tusha më 23 maj 2013, për ta mbrojtur denoncuesin gjatë procesit për banesën që e kishte të ligjshme. Znj. Tusha nuk ka shkuar në gjykim në seancën e 22 majit, me objekt

³⁰ Nr.172/4 prot., datë 08.01.2018.

³¹ Nr.827 prot, datë 23.01.2018.

³² Nr. 2256 prot., datë 26.12.2017.

“Kundërshtimin e urdhrin administrativ të dhënë nga Policia e Ndërtimit”, duke sjellë si pasojë shembjen e shtëpisë së tij, ku aktualisht është ngritur një pallat 8-katësh.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi V.Ç., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.

Denoncimi 5.

Në denoncimin³³ e shtetasit L.K., subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, denoncohet për korrupsion; vendim të padrejtë, të njëanshëm; zvarritje në proces; paaftësi profesionale. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit dhe vendimin nr. 504, datë 24.04.1997, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Sipas këtij vendimi, Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 5864, datë 01.11.1996, që linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 6024, datë 10.07.1996, i cili vendoste rrëzimin e padisë së ngritur nga shtetasi L. K., me objekt “Lirim banese”. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit shprehet se ankimi i paraqitur nga paditësja L.K. nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 9 i ligjit nr. 7574, datë 24.06.1992, “Për organizimin e drejtësisë” për të goditur vendimin e gjykatës. Prandaj, vendimi i Gjykatës nr. 5864, datë 01.11.1996, mbetet i pacenuar. Vendimi i Gjykatës së Rrethit ka datën 09.07.1996 dhe jo 10.07.1996.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasi L.K., nuk ka indice për të provuar pretendimin e tij.

II.3 Rekomandimi për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet e mësipërme dhe, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi profesionale në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor të vendimeve gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit ka treguar se ka aftësi të përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. Vendimet e subjektit paraqiten të qarta dhe të kuptueshme, duke përfshirë dhe strukturën dhe mirorganizimin e vendimit, si dhe cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik që i bën vendimit gjyqësor.

b) Lidhur me aftësinë organizative

Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi organizative për përballimin e ngarkesës në punë. Sipas shkresës 6/1 prot., datë 10.01.2018, të Gjykatës Kushtetuese, gjatë periudhës së fundit 3-vjeçare, subjekti ka shqyrtuar një total prej 120 çështjesh/dosjesh. Të gjitha çështjet/dosjet e kësaj periudhe, të shqyrtuara nga ky subjekt rivlerësimi në cilësinë e relatores, janë përfunduar në vendimmarrje të Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve apo trupës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, janë konstatuar disa parregullsi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në to. Parregullsitë janë evidentuar

³³ Shkresa nr. 1425 prot., datë 02.02.2018

lidhur me fillimin e shqyrtimit të çështjeve jashtë afatit ligjor nga paraqitja e kërkesës; kohëzgjatje gjyqimor përtej afatit ligjor; mungesë e nënshkrimit të relacionit të Këshilltares Ligjore drejtuar Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, me mendimin që çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancën plenare; nuk ka akt të gjyqtarëve për caktimin e seancës gjyqësore.

c) Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nisur nga rezultati i denoncimeve për këtë subjekt, verifikimi i tyre për periudhën e rivlerësimit, ka treguar angazhim dhe etikë në punë.

Nga shqyrtimi i dosjes për këtë subjekt, nuk kanë rezultuar të dhëna në lidhje me ndikim apo presion të jashtëm. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 5 denoncime në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, të cilat nuk paraqesin indice për veprime të kryera që cenojnë integritetin apo përbëjnë gjetje për paanësinë e saj gjatë ushtrimit të detyrës.

d) Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aftësi komunikimi dhe ka shprehur gatishmëri për t'u angazhuar në aktivitete profesionale që lidhen me fushën e gjyqësorit.

Subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit si gjyqtarë e Gjykatës Kushtetuese, nuk ka ndjekur formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe nuk ka qenë subjekt i raporteve të Inspektoratit të KLD-së.

Për sa më sipër unë, Valbona Sanxhaktari, në cilësinë e relatores së çështjes, pasi hetova raportin e KLD-së dhe denoncimet, nuk gjeta indice apo elemente që mund të ngrija dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe propozoj: “E aftë”

III. Kontrolli i figurës

III.1 Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha.*

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, nisur këto nga disa informacione të marra nëpërmjet burimeve e mediave.

Më konkretisht, informacioni i kërkuar ishte lidhur me çështjen e shumëpërfolur të shtetasit G. D. dhe përfshirjen e një grupi gjyqtarësh në gjykimin e kësaj çështjeje penale, e cila bëri bujë mediatike³⁴ dhe u konkludua me uljen e dënimit për këtë shtetas; mbi një çështje tjetër shumë të përfolur mediatikisht, që ka pasur si qëllim shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të Vendimit nr. 200, datë 13.3.2013, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe bashkimit të përkohshëm të operatorëve “***” S.A., dhe “***” A.G.”, si dhe shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i Vendimit nr. 498, datë 30.05.2013, i

³⁴ Gazeta “Panorama” online, e datës 12 nëntor 2017; “Shqiptarja.com”, e datës 10 nëntor 2017.

Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, kërkesë për të cilën në përfundim të gjykimit Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin³⁵. Po ashtu, është pyetur DSIK-ja edhe për personin e lidhur me të, Z. P. Ndue T., i cili në disa prej dokumenteve të nënshkruara prej tij figuron edhe me emrin P. N. T.

Për këto çështje janë pyetur Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, si edhe Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku është kërkuar informacion mbi pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit.

III.2 Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.

IV. Njoftimet e subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë të monitorimit

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit (i) u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj dhe (ii) dërgoi shpjegime me shkrim, në datën 28.03.2018, trupa gjykuese nr. 3, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Theo Jacobs, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, Znj.Vitore Tusha, në seancë dëgjimore në datën 04.04.2018, ora 10:00, në sallën e Pallatit të Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit. Znj. Tusha është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, në datën 28.03.2018, për të cilin edhe ka konfirmuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 04.04.2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe përfaqësohej edhe nga avokat Arben Vani, i pajisur me licencën nr. 82. Ajo nuk paraqiti pretendime të reja shtesë, veç atyre që kish paraqitur gjatë procedurës së njohjes me dosjen dhe rezultatet e hetimit administrativ.

Në seancë, subjektit të rivlerësimit iu drejtuan dy pyetje mbi njohuri dhe aftësi në fushën e së drejtës, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën. Pyetja e parë iu drejtua nga relatori i çështjes dhe pyetja e dytë nga vëzhguesi ndërkombëtar. Znj.Tusha pranoi t’u përgjigjej pyetjeve, duke shprehur mendimin e saj ligjor.

VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e

³⁵ Shkresa sekret nr. *** prot., datë 12.12.2017.

rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se:

Së pari, trupa gjyquese mori në analizë kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të ILDKPKI-së, konkluzionet e nxjerra pas hetimit, informacionet e kërkuara nga subjektet e së drejtës publike, sipas nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe pretendimeve dhe provave të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në procesin e rivlerësimit të subjektit përfshihet kontrolli i pasurisë, referuar nenit D, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me ligjin. ILDKPKI-ja kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, si dhe për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit. Sipas nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së, e cila zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me legjislacionin në fuqi. Referuar nenit 33 të ligjit, në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Neni 33 i ligjit, mes të tjerash, parashikon se Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose Kolegjit të Apelimit.

Vetë Kushtetuta i ka njohur ILDKPKI-së kompetencën për realizimin e procedurës së kontrollit të deklaratës dhe përgatitjen e raportit të hollësishëm në lidhje me ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklaramit. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kushtetutëbërësi ka përcaktuar qartësisht organin që do të kryejë procedurën e kontrollit të deklaratës dhe kompetencat e këtij organi, të cilat janë detajuar më tej në ligjin nr. 84/2016. Edhe pse ligji ka parashikuar në mënyrë më të detajuar kompetencat e ILDKPKI-së dhe rolin e saj konkret në këtë proces, nuk rezulton që ato të bien ndesh me kompetencën kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe as e cenojnë në thelb atë³⁶.

Kompetencat që i janë njohur ILDKPKI-së në procesin e rivlerësimit janë në përputhje edhe me kompetencat dhe misionin që ai kryen në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i konceptuar si organ qendror dhe i specializuar kontrolli në rregullimin institucional që i është bërë sistemit të mbledhjes dhe përpunimit të deklaratave të zyrtarëve publikë, zbatimi i të cilit konsiderohet si një element i rëndësishëm në luftën antikorrupsion. Nisur nga misioni i tij, detyrat funksionale, si edhe eksperiencia dhe infrastruktura ekzistuese e ngritur në këtë drejtim, jo pa qëllim kushtetutëbërësi e ka përcaktuar atë si organin që do të kryejë vlerësimin paraprak të deklaratës, por jo vetëm në

³⁶ V-2/17, GjK, pika 27.

drejtim të aspektit formal, por edhe atij substancial, pra edhe të ligjshmërisë së pasurive të deklaruara³⁷.

Hetimi administrativ i thelluar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

Ky hetim është përqendruar, mbi të gjitha, te pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, Znj. Tusha.

Së dyti, trupa gjyquese mori në analizë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të Inspektoratit të KLD-së, konkluzionet e nxjerra pas hetimit të denoncimeve të pesë shtetasve, informacioneve të kërkuara nga institucionet, sipas nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, dhe argumenteve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit.

Nga faktet rezultoi se janë konstatuar disa parregullsi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Parregullsitë janë evidentuar lidhur me fillimin e shqyrtimit të çështjeve jashtë afatit ligjor nga paraqitja e kërkesës; kohëzgjatje gjykimi përtej afatit ligjor; mungesë e nënshkrimit të relacionit të këshilltares ligjore drejtuar Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, me mendimin që çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancën plenare; nuk ka akt të gjyqtarës për caktimin e seancës gjyqësore.

Për sa është konstatuar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vlerëson të analizojë dispozitat e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016³⁸ “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe rregulloren e brendshme “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”.

Duke pasur parasysh se dosjet objekt vlerësimi i përkasin periudhës para ndryshimit të ligjit nr. 8577/2000, referimi në dispozitat e ligjit dhe analizimi i fakteve bëhet sipas rregullimit ligjor të periudhës objekt vlerësimi profesional të subjektit të rivlerësimit.

Në nenin 35 të ligjit nr. 8577/2000 “Detyrat e gjyqtarit në gjykimin kushtetues” parashikohet se: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të përgatisë çështjen për gjykim, si dhe të marrë masat e duhura për zhvillimin e seancës plenare;

b) të votojë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes;

c) të ruajë sekretin e diskutimeve dhe të votimit”

Rregullorja e brendshme e Gjykatës Kushtetuese³⁹ “Mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës”, në nenin 27, “Grupi i këshilltarëve të gjyqtarëve”, në pikën 2 dhe 3, parashikon: “(2) Këshilltarët e gjyqtarëve ushtrojnë funksione ndihmëse e këshillimore në procesin vendimmarrës të Gjykatës. Ata janë të ndarë pranë secilit gjyqtar. Për çështje të veçanta, kryetari mund të caktojë një grup këshilltarësh për përgatitjen e opinionëve përkatëse.

³⁷ V-2/17, GJK, pika 28.

³⁸ Ligji nr. 99/2016, është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 8 nëntor 2016.

³⁹ Kjo rregullore ka hyrë në fuqi më 15.06.2009.

(3) Këshilltari jep mendimin e tij për kalimin ose jo të kërkesës për gjykim. Kur vendoset kalimi i çështjes për gjykim, këshilltari përgatit opinionin e tij mbi zgjidhjen e çështjes dhe, me miratimin e relatorit, harton projektvendimin. Nëse gjyqtarët e konsiderojnë të nevojshme, këshilltarët mund të marrin pjesë në diskutimet e Mbledhjes së Gjyqtarëve, për çështje të ndryshme.”

Ndërsa në nenin 28 të Rregullores “Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit” parashikohet se: *“(1) Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit ka si funksion kryesor pranimin dhe regjistrimin fillestar, si dhe përpunimin e mëtejshëm të të gjitha kërkesave që i drejtohen për shqyrtim Gjykatës. Në kryerjen e këtij funksioni kryen këto detyra:*

(a) regjistrimin e kërkesave të ardhura në Gjykatë. Gjatë këtij procesi ushtrohet kontrolli lidhur me plotësimin e kushteve të parashikuara nga nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe përgatiten dosjet përkatëse;

(b) komunikimin e vazhdueshëm me kërkuarë, subjektet e interesuara, ose përfaqësuesit e tyre, si dhe korrespondencën me gjykatat e tjera të nevojshme për gjykimin kushtetues;

(c) përgatitjen e listës së çështjeve që do të gjykohen nga Gjykata për këshilltarët e gjyqtarëve, si dhe për Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë;

(ç) zbardhjen e vendimeve, si dhe dërgimin e kopjeve të tyre pjesëmarrësve në gjykim dhe Qendrës së Publikimeve Zyrtare, me qëllim botimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare;

(d) përgatitjen e statistikave për çështjet e gjykuara nga Gjykata, në fund të 6-mujorit dhe vitit, me qëllim pasqyrimin periodik të tyre në faqen e internetit;

(dh) mbajtjen e procesverbaleve të seancës gjyqësore dhe lidhjen e dosjeve pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit.”

Në analizë të fakteve të konstatuara dhe në vështrim të dispozitave ligjore dhe nënligjore të mësipërme, përgjegjësia për parregullsitë e konstatuara në drejtim të aftësisë për të administruar dosjet është edhe e stafit të Drejtorisë Gjyqësore. Lidhja dhe administrimi i akteve pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes është detyrë funksionale e stafit administrativ gjyqësor të drejtorisë përkatëse. Po kështu, edhe përgatitja e akteve procedurale për gjykim nga ana e këshilltarit, jo vetëm që është detyrë funksionale e tij, por njëkohësisht dhënia e opinionit pa dyshim që formalizohet nëpërmjet nënshkrimit të aktit, relacionit përkatës. Relacioni i panëshkruar nga ana e këshilltares ligjore, si parregullsi e konstatuar nga ana formale, përveçse është përgjegjësi individuale e këshilltarit, njëkohësisht është edhe parregullsi e gjyqtarës, e cila duhet të bazohet për vijimin e procesit mbi akte, relacion të nënshkruar, por që në rastin konkret nuk ka sjellë pasoja për shqyrtimin, apo zhvillimin e mëtejshëm të procesit gjyqësor të çështjes së verifikuar.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mori në analizë edhe konstatimin tjetër sa i përket afatit të shqyrtimit të çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, i cili, sipas nenit 47 të ligjit nr. 8577/2000, parashikonte se, shqyrtimi i çështjeve në Gjykatën Kushtetuese duhet të fillojë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e kërkesës. Mbi bazën e kësaj dispozite është konstatuar se shqyrtimi i çështjes në tri raste nga gjyqtarja ka filluar jashtë afatit 2-mujor nga paraqitja e kërkesës.

Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë konstatim ka sqaruar se: *Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit të evidentuar të paarsyeshëm në çështjen me kërkuar V.K., sqaroj se në këtë afat ka ndikuar edhe fakti që kërkesës fillestare të Gjykatës Kushtetuese për të vënë në dispozicion të saj dosjen*

gjqësore, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i është përgjigjur duke përcjellë vetëm një pjesë të akteve, arsye për të cilën i jemi drejtuar përsëri disa herë për akte të tjera të nevojshme për t'u verifikuar, sipas korrespondencës që ajo ka bashkëngjitur.

Gjykata Kushtetuese e shqyrton kërkesën brenda një afati të arsyeshëm. Komisioni vëren se ndryshimet e fundit në ligjin nr. 8577/2000, ndër të tjera kanë parashikuar edhe zgjatjen e afatit të shqyrtimit të çështjes nga paraqitja e kërkesës. Neni 41 i ligjit nr. 99/2016 ka ndryshuar nenin 47 të ligjit nr. 8577/2000 në këtë mënyrë: “1. Shqyrtimi i çështjeve nga kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve përfundon brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton afate të tjera. Në çdo rast bisedimet dhe marrja e vendimit nga kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve bëhet mbi bazën e projektvendimit të përgatitur nga relatori. 2. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet pasi të jenë depozituar paraprakisht nga palët të gjitha materialet e nevojshme për gjykim, si dhe çështja të jetë përgatitur në tërësi nga relatori i çështjes. Relatori i çështjes paraqet në bisedime projektvendimin përkatës, mbi të cilin votojnë të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në votim. 3. Vendimi përfundimtar shpallet i arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”.

Në vlerësimin e mosrespektimit të afatit për shqyrtimin e çështjes nga momenti i paraqitjes së kërkesës, edhe ligjvënësi ka vlerësuar se ky afat duhet të ketë një shtrirje më të gjatë në kohë.

Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar:

*“Lidhur me fillimin e shqyrtimit të çështjeve, që sipas nenit 47 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese duhet bërë jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e kërkesës, parashtroj se: në çështjet me kërkuar: B.J., shoqëria “***” sh.p.k., dhe V.K., në të cilat kundërshtohen vendime gjyqësore, ku dhe është konstatuar fillimi i shqyrtimit jashtë afatit, është vërejtuar që në fazën përgatitore të studimit të kërkesës dhe materialeve bashkëngjitur, ka qenë domosdoshmëri marrja e dosjes gjyqësore. Në funksion të shqyrtimit në tërësi të çështjeve, janë kërkuar dosjet gjyqësore, pa të cilat nuk mund të vijonin më tej procedurat. Kjo rrethanë ka ndikuar në datën e fillimit të shqyrtimit të këtyre çështjeve, çka nuk ka qenë e nevojshme në shqyrtimin e kërkesave për kontroll abstrakt të akteve normative.”.*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vlerëson se, në bazë të të gjithave rrethanave dhe kushteve të mësipërme, parregullsitë e konstatuara në organizim janë formale dhe nuk janë të asaj natyre dhe asaj shkalle sa të cenojnë aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe të mund të cilësohen në një vlerësim me mangësi për të, pasi janë periferike dhe nuk cenojnë nivelin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit në përgjithësi në kuptimin dhe në nivelin që e kërkon ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Trupa gjyqësore vlerëson se aftësitë për organizimin duhet të shihen edhe në raport me përbërësit e tjerë të vlerësimit profesional të marrë në tërësinë e tyre.

Së treti, trupa gjyqësore mori në analizë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, raportin e arsyetuar të DSIK-së, konkluzionet e nxjerra pas hetimit të pavarur, mbi pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

Referuar nenit 35/2 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja menjëherë ka filluar procedurën e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, Znj. Vitore Tusha, e cila ka plotësuar formularin përkatës. DSIK-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit të figurës së subjektit, sipas parashikimeve të neneve 34 deri në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka përfunduar kontrollin për figurën e subjektit

të rivlerësimit, ka dërguar raportin përfundimtar, sipas të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të gjyqtares, Znj. Vitore Tusha.

Trupa gjykuese mban parasysh se, kompetencat e DSIK-së për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të. Për më tepër, kjo është e rëndësishme për të evituar çdo ndërhyrje të mundshme nga organet në varësi të pushtetit ekzekutiv, veçanërisht në rastin e kontrollit të figurës, shqetësim ky i ngritur edhe në opinionin e Komisionit të Venecias.

Komisioni ushtroi të drejtën e kontrollit të pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, duke marrë indice nga burime mediatike, lidhur me dy raste të përfolura në mediat e shkruara. Nga bashkëpunimi me organet shtetërore kompetente për kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, bashkëshortit të saj, rezultoi se nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Znj.Vitore Tusha, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës Kushtetuese.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

ALMA FASKAJ

**Kryesues
Firma**

Valbona SANXHAKTARI

**Relator
Firma**

Xhensila PINE

**Anëtar
Firma**

Sekretare gjyqësore

Ina Serjanaj

Firma

U shpall në Tiranë, më datë 05.04.2018.